



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Inspektorati i Punës

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2021

Prishtinë
Dt. 04.02.2022

Zëvendësuesi i Drejtorit të Inspektoratit të Punës
Agim Millaku

AUTOR I KËTIJ RAPORTI ËSHTE ZËVENDËSUESI I DREJTORIT TË INSPEKTORATIT TË PUNËS:

AGIM MILLAKU

Raporti i hartuar është bazuar në raportet e hartuara nga Departamenti për Planifikim dhe Çështje Ligjore në Inspektoratin e punës.

Departamenti për Planifikim dhe Çështje Ligjore raportet i ka hartuar në bazë të raporteve me të dhënat e punës së inspektorëve të punës, përcjellë nga udhëheqësit e divizioneve për koordinim të inspektorëve të punës në regjione.

Përmbajtja

Hyrje	6
Inspektorati i Punës.....	7
Realizimi i detyrave të punës nga Inspektorati i Punës në vitin 2021	9
Përfundim.....	14
Konkluzionet.....	15
Grafikonet	16
Raporti zyrtar	16
Marrëdhënia e punës	22
Siguria dhe shëndeti në punë	26
Krahasimi ndër vite (2016 – 2021)	29

Tabela e figurave

Figura 1: Inspektimet ndër muaj	16
Figura 2: Inspektimet ndër muaj sipas sektorëve.....	16
Figura 3: Inspektimet sipas ankesës ndër muaj.....	17
Figura 4: Inspektimet sipas veprimtarisë	17
Figura 5: Inspektimet sipas llojit të inspektimit.....	18
Figura 6: Inspektimet sipas ankesës të ndarë në sektorë.....	18
Figura 7: Inspektimet sipas ankesës ndër muaj (për sektor)	19
Figura 8: Masat administrative	19
Figura 9: Rastet në shkallë të dytë	20
Figura 10: Punëtorët/et e inspektuar/a ndër muaj	20
Figura 11: Gjobat ndër muaj	21
Figura 12: Punëtorë/e dhe subjekte të legalizuara ndër muaj	22
Figura 13: Punëtorët e inspektuar me kontrata të punës ndër muaj	22
Figura 14: Punëtorët/et pa kontrata të punës ndër muaj sipas gjinisë.....	23
Figura 15: Shkeljet e evidentuara në kompenzime, paga jubilarë, dhe shujta.....	24
Figura 16: Punëtorët/et e inspektuar/a sipas veprimtarisë	25
Figura 17: Angazhimi i ekspertëve për Siguri dhe Shëndet në Punë.....	26
Figura 18: Obligimet e punëdhënësit	26
Figura 19: Aksidentet në vend të punës	27
Figura 20: Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve/eve	27
Figura 21: Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve	28
Figura 22: Inspektime të rregullta ndër vite	29
Figura 23: Inspektime të përsëritura	29

Figura 24: Inspektime me kërkesë të palës	30
Figura 25: Inspektime të përbashkëta	30
Figura 26: Punëtorë/e të legalizuar/a	31
Figura 27: Vërejtje të shqiptuara.....	31
Figura 28: Gjoba të shqiptuara.....	32
Figura 29: Punëtorë/e të inspektuar pa kontrata	32
Figura 30: Punëtorë/e të inspektuar/a (sipas gjinisë)	33
Figura 31: Planifikimet emergjente	33
Figura 32: Obligimet e punëdhënësit	34
Figura 33: Aksidentet në punë	34
Figura 34: Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve	35
Figura 35: Kushtet teknike.....	36

Hyrje

Gjendja përgjithshme në Kosovë në fushën e marrëdhënies së punë, sigurisë dhe shëndetit në punë të punëtorëve në vendet e tyre të punës është jo e kënaqshme në kuptimin e realizimit të drejtave të tyre sociale. Ne në raport do të fokusohemi në prezantimin e punës së Inspektoratit të Punës, inspektorëve të punës në veçanti si dhe me sfidat që e kanë përcjellë këtë Organ në ushtrimin e funksionit të vetë në mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore të cilat e rregullojnë këtë lëmi të punës. Zbatimi i dispozitave pozitive nënkupton krijim të raporteve të ligjshme nga marrëdhënia e punës si dhe kushte më të sigurt dhe të shëndetshme për punëtorët në vendet e tyre të punës. Mandatin për ushtrimin e mbikëqyrjes së dispozitave pozitive ligjore që rregullojnë lëmin e punës e ka Inspektorati i punës bazuar në ligjin për Inspektoratin e Punës – Ligji Nr.2002/9 .i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr.2002/9. Me këto ligje është përcaktuar fusha e veprimit të këtij Organi, organizimi i tij, detyrat dhe përgjegjësitë , marrja e vendimit , procedura e vendosjes sipas ankesës dhe përgjegjësia e këtij Organi para Ministrisë.

IP –ja vazhdimisht ka bërë përpjekje të ngrit cilësinë inspektuese, po ashtu të rris edhe numrin e inspektimeve në subjektet punuese me qëllim që cilësia në inspektim dhe prezenca jonë ta shtoi interesimin dhe ti mobilizoi palët në procesin e punës, të punojnë në pajtim me normat ligjore, kështu të ndikohet të krijohen kushte më të mira në punë, më të sigurt dhe më të shëndetshme për punëtorët në vendet e tyre të punës.

IP ka vepruar edhe gjatë vitit 2021 në realizimin e synimeve zhvillimore në pajtim me Planin Strategjik Zhvillimor të miratuar nga ministria për periudhën kohore 2017-2021.

Në pajtim me politikat e MFPT dhe bazuar në vizionin, misionin dhe objektivat strategjike zhvillimore të përcaktuara në planin strategjik zhvillimor, kemi krijuar politikat tona zhvillimore dhe i kemi përcaktuar prioritetet në realizimin e këtyre politikave.

Ne kemi trashëguar një gjendje të rënduar në ushtrimin e funksionit tanë për shkak të kapaciteteve të pa mjaftueshme njerëzore po edhe mungesës logjistike.

Viti 2021 ka qenë një vit me shumë sfida të pa parapara sepse u gjendem në një situatë pandemie e cila edhe ashtu gjendjen e rënduar në ushtrimin e mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave pozitive nga marrëdhënia e punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, e rëndoi edhe më shumë.

Gjendja e përgjithshme e krijuar ka bërë që takimet me përfaqësuesit e punëdhënësve dhe përfaqësuesit e punëtorëve të shmangen për arsye sepse nuk kishim kushte teknike për organizimin dhe realizimin e këtyre takimeve.

Besimi në punën e Inspektoratit të punës po shtohet gjithnjë e më shumë te punëtorët po edhe te punëdhënësit. Tregues për këtë është rritja e numrit të ankesave drejtuar këtij organi për realizimin e të drejtave të tyre nga puna, si në lëmin e marrëdhënies së punës edhe në lëmin e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendet e tyre të punës.

Jemi duke punuar në vlerësimin e rris qeve, në gjetjen e faktorëve ndikues që ndikojnë negativisht ose ma mirë me thënë ti identifikojmë ma afër shkaqet që pengojnë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore efikase, në kohë dhe cilësore.

Inspektorati i Punës

IP-ja është Organ i pavarur ekzekutiv i man datuar me legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore pozitive të cilat rregullojnë marrëdhëniet juridike kontraktuale, të drejtat dhe detyrimet e palëve në raportet e krijuara juridike në procesin e punës.

IP udhëhiqet nga Kryeinspektori i Punës i ndihmuar nga tre zëvendësit e tij me përgjegjësi (për marrëdhënien e punës, sigurinë në punë dhe shëndetin në punë). Kryeinspektori për punën e tij dhe të institucionit që ai udhëheq i raporton drejtpërdrejt ministrit të MFPT.

Struktura e IP-së përbëhet prej pjesës ekzekutive dhe pjesë administrative.

1. Pjesën ekzekutive e përbëjnë:

Kryeinspektori i Punës, tre zëvendësit e Kryeinspektorit të Punës (zëvendësi për marrëdhënie pune, zëvendësi për siguri në punë dhe zëvendësi për shëndet në punë) dhe inspektorët e punës.

2. Pjesa administrative përbëhet nga:

Departamenti per Çështje ligjore dhe planifikim strategjik

Departamenti për Administratën e Përgjithshme, Buxhet dhe Financa

Divizionet Rajonale per Koordinim (7 Rajone)

Njësia për personel.

Në total numri i të punësuarave në IP gjatë vitit 2021 është 55 punëtor.

Numri i përgjithshëm i inspektorëve të punës të cilët e ushtrojnë funksionin e vet në tërë territorin e Republikës së Kosovës është 37, prej tyre 5 veprojnë vetëm në komunat e pjesës

veriore të Kosovës. Sipas strukturës gjinore 31 janë meshkuj dhe 6 femra., sipas strukturës nacionale 29 janë shqiptar dhe 8 janë serb. Sipas strukturës profesionale: 6 profileve teknike (2 makineri, 2 ndërtimtari dhe 2 kimi), 2 ekonomist dhe 29 jurist.

Si çdo vit edhe në vitin 2021 në pajtim me planin strategjik zhvillimor IP-ja ka planifikuar ta rris kapacitetin njerëzor si në kuptimin e shtimit të numrit të inspektorëve të punës edhe në ngritjen profesionale të tyre në ushtrimin e funksionit të tyre. Ky numër jo që nuk është rritur por përkundrazi është zvogëluar.

Ligjet dhe aktet nënligjore zbatimin e të cilave e mbikëqyr Inspektorati i Punës janë:

- **Ligjit Nr.03/L-212 të Punës,**
- **Ligjit Nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë**

Përveç këtyre dy ligjeve bazë IP-ja mbikëqyrë edhe zbatimin e disa dispozitave të veçnat të disa ligjeve tjera si në vijim:

- **Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit,**
- **Ligji nr. 03/L-200 për Grevat,**
- **Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara**
- **Ligji Nr.04/L-219 Për të Huajt**
- **Ligji Nr.04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë**
- **Ligji Nr.02/L-81për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri**
- **Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.**

IP-ja mbikëqyrë edhe zbatueshme rinë e akteve nënligjore që dalin nga këto ligje e që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës , sigurinë dhe shëndetin në punë.

Fusha e zbatimit të këtyre ligjeve përfshijnë sektorin publik, publiko –privat dhe privat nga marrëdhënia e punës ndërsa nga siguria dhe shëndeti në punë përfshihet edhe administrata shtetërore në nivel qendror dhe atë lokal. Këto ligje kanë efekt juridik përveç për shtetasit e Republikës së Kosovës edhe për shtetasit e huaj që ushtrojnë veprimtari pune në Republikën e Kosovës qoftë si persona juridik, qoftë si persona fizik.

Realizimi i detyrave të punës nga Inspektorati i Punës në vitin 2021

IP-ja nëpër mjet të inspektimeve në subjektet punuese si në sektorin publik edhe në sektorin privat ushtron mbikëqyrje të respektimit të dispozitave pozitive ligjore në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve në procesin e punës (punëdhënësve dhe punëtorëve). Kështu nëpër mes të inspektimeve cilësore dhe shtimit të pranisë së inspektorëve në këto subjekte, nëpër mes këshillimeve për punëdhënësit, për punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre ndikohet në përmirësimin e organizimit të procesit të punës, në shmangëjen e formave diskriminuese, të arrihet ti binden palët të investojnë më shumë në krijimin e mirëbesimit, sigurimit të kushteve më të mira, më të sigurta dhe më të shëndetshme për punë, në trajnimin e punëtorëve për punë të sigurtë, që punëtorët ti përdorin dhe mirëmbajnë mjetet dhe pajisjet e punës në mënyrë të rregullt, që punëtorët ti përdorin në mënyrë të rregullt pajisjet personale mbrojtëse etj. Me ngritjen e vetëdijes se investimi në siguri, shëndet, ambient të përshtatshëm për punë, rritje të profesionalizmit, respektimit, zbatimit dhe ekzekutimit të drejtave që burojnë nga dispozitat pozitive, heqim shprehitë e këqija në punë duke i zëvendësuar me shprehitë e mira për punë dhe përfundimisht do të shtohet motivimi i punëtorëve për të qenë më të frytshëm në procesin e punës. Atëherë, me punëtor profesional dhe të motivuar do të shtohet produktiviteti, do të kemi numër më të vogël të aksidenteve në punë, do të zvogëlohen humbjet materiale si dhe do të kemi punëtor të shëndetshëm. Me punën e vetë Inspektorati i punës ndikon që puna e ndershme të bëhet realitet.

IP-në vazhdimisht që nga themelimi ka pasur vështirësi në ushtrimin e funksionit të vetë. Kjo për arsye të kapaciteteve të pa mjaftueshme njerëzore, teknike dhe logjistike, mungesës së zyrave adekuate për inspektorët, si dhe nevojave për trajnime për të kryer inspektime bazuar në kushtet e reja të krijuara.

Pengesë kryesore e kemi pasur numrin e vogël të inspektorëve të punës. Nëse kemi parasysh se çdo subjekt punues duhet të inspektohet së paku një herë në vit dhe se sipas të dhënave kemi mbi 75000 subjekte aktive të cilat kanë punëtorë të deklaruar, atëherë e shohim se numri i inspektorëve karshi numrit të subjekteve punuese është tejte i vogël. Pa mundësia të inspektohen subjektet punuese krijon mundësinë e rritjes së punës jo formale, e kështu krijohet pa barazi dhe konkurrencë e dëmshme në mes të subjekteve punuese. Punësimi jo formal shkakton dëme personale në kursimet individuale të punëtorëve dhe pa mundësinë për të realizuar të drejtat e garantuara me dispozitat pozitive ligjore, pa siguri fizike, pa qëndrueshmëri në punë, shfrytëzim të shërbimeve pa pagesë me orar të tej zgjatur, trajtim të pa

barabartë dhe diskriminues etj. si dhe evazion fiskal. Punëtorët jo formal nuk kanë mundësi të organizohen në mbrojtjen e të drejtave të tyre, kështu ju mohohet e drejta me marrë pjesë aktive në organizimin e procesit të punës, si dhe mundësia për ti gëzuar të drejtat që i kanë të garantuara me dispozitat pozitive. Edhe më tutje niveli i përfaqësimit të punëtorëve në mbrojtjen e interesave të tyre është në nivel shumë të ulët, kjo veçanërisht në sektorin privat. Me gjithë numrin e vogël të inspektorëve, kushteve të vështira për punë, mungesës së mjeteve për punë, mungesës së makinave, mungesës së punëtorëve për kryerje të shërbimeve, mungesës së bazës së të dhënave, stimulimit jo të duhur(nuk iu paguhet rrezikshmëria në punë, iu janë shkurtuar mbushjet për telefona për komunikim) dhe gjendjes së përgjithshme të rënduar për shkak të pandemisë, IP-ja ka arritur të kryej misionin e vet suksesshëm. *Gjatë vitit 2021 IP-ja ka kryer 10162 inspektime në total:(të planifikuara 3022, të përsëritura 1601, të jashtëzakonshme (rastësore) 38, Inspektime për shkak të aksidenteve në punë 238, inspektimet në bashkëpunim me institucionet tjera të mbikëqyrjes 108 dhe inspektimet sipas ankesës së palëve 5155.* 5 inspektor janë në komunat veriore të Kosovës (Mitrovicë, Z veçan , Zubin Potok dhe Leposaviq). Në inspektimet e kryera janë trajtuar gjithsejtë **38035** punëtor. Nga numri i përgjithshëm i punëtorëve (26428 meshkuj , 11607 femra). Prej këtyre punëtorëve 35 punëtor kanë qenë të huaj, 6 të gjinisë mashkullore dhe 29 të gjinisë femërore. Gjatë vitit 2021 me prioritet janë trajtuar rastet e aksidenteve në vend të punës në të cilat kanë pësuar lëndime punëtorët që kryenin punë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Gjithsejtë kanë ndodhur 188 raste aksidentale në të cilat:

- 139 aksidente me pasojë lëndime të lehta,
- 40 aksidente me pasojë lëndime të rënda dhe
- 9 aksidente kanë përfunduar me fatalitet ose vdekje në punë.

Shkeljet më të shpeshta të dispozitave ligjore të cilat i kanë bërë punëdhënësi-it ndaj punëtorëve në lëmin e marrëdhënies së punës janë: nuk iu paguhen pagat jubilarë 1959, mos realizimi i shujtave 1362 raste, ndërprerja e marrëdhënies së punës 142, puna gjatë vikendeve 1027, puna jashtë orarit të punës të punës 344, pushimet vjetore 332, kompensimi i pagave 781, ndërprerja e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit kundërligjshëm në 142 raste, punëtor me kontrata të punës por të pa lajmëruar në ATK 433, punëtor pa kontrata dhe të pa lajmëruar 1459 punëtor, mos lidhja e kontratave të punës (pa kontrata të punës janë gjetur të punojnë 483 punëtor), iu ka mohuar e drejta në pushim vjetor 332 (nuk iu jepet pushimi dhe as nuk iu paguhet ose edhe nëse iu jepet pushimi iu shkurtohet numri i ditëve të pushimit), 1 rast nuk iu

janë paguar pagat minimale të garantuara, në 1027 raste nuk iu kanë paguar orët e punës të realizuara në ditët e pushimit javor, në 344 raste nuk iu kanë paguar orët shtesë të punës etj.

Nga siguria dhe shëndeti në punë pa rregullsitë më të shpeshta të evidentuara kanë qenë: pa pajisje personale mbrojtëse 1909 punëtor, vlerësimin e rriskut nuk e kishin 530 subjekte, 46 subjekte me punëtor më shumë se 50 e më pak se 250 punëtor nuk kishin angazhuar punëtor ekspert nga SSHP, 6 subjekte me mbi 250 të punësuar nuk kanë të angazhuar punëtor të sigurisë dhe shëndetit në punë, në 668 subjekte më numër më të vogël se 50 punëtor nuk kishin fare të caktuara person për përkujdesje nga siguria dhe shëndeti në punë dhe edhe vetë punëdhënësit ishin të pa certifikuar, 1389 subjekte nuk kishin punëtor të trajnuar për dhënien e ndihmës së parë, në 138 subjekte nuk ka të organizuar shërbim për dhënien e ndihmës së parë, në 57 subjekte nuk është organizuar kujdesi emergjent, shërbimi i mbrojtjes kundër zjarrit nuk është i organizuar në 293 subjekte punuese, daljet emergjente nuk janë siguruar në 69 subjekte, në 54 subjekte nuk ka të zgjedhur përfaqësues të punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë, përdorimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve personale mbrojtëse nuk bëhet e rregullte nga punëtorët në 179 raste, njoftimi i punëdhënësit për rrezikun nuk është bërë në 254 raste, tualetet dhe dhomat për ndërrim nuk janë siguruar për punëtorët nga 302 subjekte, në 609 subjekte nuk janë vendosur shenjat përkatëse për sinjalizim (të rrezikut 250, shenjat e detyrimit në 70 raste, 9 raste mungojnë shenjat e lejimit, shenjat për daljet emergjente mungojnë në 145 subjekte, 135 raste nuk ka shenjëzim për tualetet) Kushtet teknike jo të duhura për punë të sigurtë ishin në 650 subjekte, : drita e pa mjaftueshme në 227 raste, pa certifikata teknike pajisjet në 204 raste, dridhje mbi kufijtë e lejuar në 17 raste etj, Kontrollimet mjekësore nga mjekësia e punës për punëtorët nuk janë kryer si në vijim: 2129 punëtor nuk i kishin bërë kontrollimet paraprake mjekësore dhe për 1964 punëtor nuk i kishin kryer kontrollimet periodike mjekësore dhe plani emergjent iu mungonte 11 subjekteve punuese.

Për parregullsitë e gjetura në mos respektimin e dispozitave ligjore janë ndërmarr masat administrative si më poshtë: 2872 vërejtje, 176 pezullime të punës, 281 gjoba të shqiptuara, 80 gjoba të realizuara, 1020 lëndë janë proceduar në shkallë të dytë me ankesë, 68 lëndë janë në procedurë përmbartimore, 10 përgjigje në padi janë bërë, 8 lëndë të përmbartuara.

Për shkelje të të drejtave nga puna në shkallën e dytë të IP janë bërë 1633 ankesa të palëve kundër vendimeve të shkallës së parë, prej tyre 83 ankesa janë refuzuar si të pa bazë, 798 ankesa janë aprovuar, 161 lëndë janë kthyer në rishqyrtim shkallës së parë, 3 palëve iu është aprovuar pjesërisht ankesa. Gjithsejtë në inspektimet e kryera nga inspektorët e punës janë

trajtuar 38035 të punësuar 26434 meshkuj dhe 11636 femra. Nga këta 35 punëtor të huaj, 6 meshkuj dhe 29 femra.

IP gjatë tërë periudhës ka pasur vështirësi nga më të ndryshmet në ushtrimin e funksionit të vetë, duke u nisur prej kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore, teknike dhe logjistike, mungesës së zyrave dhe përgatitjes së inspektorëve nëpër mes të trajnimeve në ushtrimin e detyrave të veta në kushtet e reja të krijuara.

Është po ashtu vështirë që të gjinden raporte për sëmundjet profesionale për shkak të mbulimit të pjesshëm të shërbimeve shëndetësore nga mjekësia e punës të ndërmarrjeve në Kosovë, mungesës së angazhimit të mjekëve të specializuar me orar të plotë në shërbimet shëndetësore në subjektet punuese etj.

Sipas ILO-s, një vend pune i denjë kërkon: ekzistimin e punës produktive, marrëdhënien e drejtë dhe të qëndrueshme të punëdhënësit karshi punonjësve të tij/saj, mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm të punës, mbrojtjen e të drejtave sociale të punonjësve dhe të familjeve të tyre, kushtet më të mira të mundshme për zhvillimin personal të punonjësve, integritet social dhe lirinë e punonjësve që t'i shprehin nevojat e tyre, të organizohen, dhe të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes (kur vendimet ndikojnë drejtpërdrejtë në punën e tyre, në jetë dhe barazi gjinore, d.m.th., barazi mes burrave dhe grave).

Vështirësi dhe sfidë për IP është synimi për të arritur që me autoritetin e vetë të ndikoi në krijimin e vendeve të punës të cilësuara nga ILO-ja si vende të punës të denja për punëtorin.. Për më tepër, Inspektorati i Punës ka nevojë të rinovojë proceset e saj të punës për të rritur efikasitetin e aktiviteteve të tij.

Gjithashtu vështirësi paraqet, vetëdijesimi i të punësuarve dhe punëdhënësve, për rolin dhe rëndësinë e realizimit të të drejtave bazike në punë, kusht ky i cili ende është i zbehtë sepse mungon informimi i tyre mbi të drejtat dhe përgjegjësit që kanë. Po ashtu vështirësi paraqet niveli i pamjaftueshëm i përfaqësimit të punëtorëve në sektorin privat, i cili është gjenerator i krijimit të vendeve të reja të punës, krijon përballje të reja në kuptimin e realizimit të të drejtave të punëtorëve nga marrëdhënia e punës, sigurisë dhe shëndetit në punë. Në fund, niveli i pamjaftueshëm i zhvillimit socio-ekonomik i vendit tonë, po ndikon drejtpërdrejt në zhvillimet e marrëdhënies së punës. Në anën tjetër luftimi i punësimit jo formal paraqet vështirësi dhe konsiderohet përballje tjetër për IP. Nga përvoja e fituar, për tu përballur me vështirësitë që dalin si rezultat i marrëdhënieve në procesin e punës, kemi ardhur në përfundim se mbikëqyrjet më të shpeshta, të koordinuara më mirë, rritjes së bashkëpunimit të mirëfilltë në mes të

institucioneve përkatëse inspektuese dhe bashkëpunimi me partnerët social, do të japin efektet më të mira në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve në mes të palëve kontraktuese në procesin e punës, do të ndikojnë në krijimin e kushteve më të sigurt dhe të shëndetshme për punë për punëtorët, do të kemi punëtor të shëndetshëm, shtim të produktivitetit, do të kemi reduktim të shpenzimeve për trajtime mjekësore të punëtorëve, numër më të vogël të aksidenteve e këtu do të kemi më pak shpenzime për zhdëmtimin e punëtorëve për rastet aksidentale, do të kemi më pak orë të humbura në punë dhe do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies sociale e fundja do të kemi familje të shëndosha dhe shoqëri të shëndosh .

IP-ja vlerëson se nëpër mes të dialogut social mund të arrihet të përcillet mesazhi te palët kontraktuese në procesin e punës, se themelimi i marrëdhënies së punës nëpër mes të respektimit të dispozitave ligjore dhe punësimit formal të punëtorëve do të rritë efektivitetin në punë dhe dobia do të jetë e ndërsjellët për palët në proces të punës, e me këtë si që u cek dobi do të ketë edhe shoqëria në përgjithësi.

Inspektorati i Punës me veprimin e vet pa reshtur vepron në tejkalimin e këtyre vështirësive, synon të kontribuojë në zhvillimin e baraspeshuar ekonomiko-social dhe prosperitetin e vendit duke ofruar shërbime inspektive të punës të drejta, të pa anshme dhe të efektshme, për të garantuar zbatueshme rinë e ligjeve, për të rritur sigurinë, mbrojtur shëndetin e punëtorëve në vendet e tyre të punës dhe të ndikojnë në zhvillimin e veprimtarisë së subjekteve punuese në kushte të barabarta dhe zhvillimit të konkurrencës së shëndosh ndërmjet tyre në ushtrimin e veprimtarisë së punës.

IP-ja veprimet e veta i ka kryer bazuar në planin e veprimit të hartuar dhe të miratuar nga MPMS bazuar në objektivat e përcaktuara për realizim sipas planit strategjik zhvillimor për periudhën 2017-2021. Përmes realizimit të këtyre objektivave do të arrihet ngritja e kapacitetit njerëzor dhe teknik në IP, përmirësim i komunikimit të IP-së me punëtorët, punëdhënësit dhe publikun në përgjithësi, do të arrihet bashkërendim më i mirë ndër-institucional në luftimin e punësimit jo formal dhe realizim më i efektshëm i të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës, garantim i kërkesave minimale të kushteve në punë të përcaktuara me standardet Evropiane, ashtu që të rritet niveli i sigurisë dhe shëndetit në vend të punës për punëtorët në procesin e punës për të siguruar të kemi punëtor të shëndetshëm, të motivuar dhe efikas.

Përfundim

IP-ja nëpër mes të inspektimeve të kryera në subjektet punuese në të dy sektorët si në sektorin publik edhe në sektorin privat, ka bërë që përherë e më shumë të kuptohet drejtë, se zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, krijon siguri për biznesin, rrit produktivitetin në punë, zvogëlon stresin , motivon punëtorët për punë, rrit sigurinë dhe mbron shëndetin e punëtorëve në vendet e tyre të punës.

Kjo vërtetohet nëpër mes të treguesve statistikor si që janë: rritjes së numrit të gjobave të shqiptuara, rritjes së numrit të masës ndëshkuese vërejtje për subjektet punuese, zvogëlimi i numrit të bizneseve që punonin në mënyrë ilegale, zvogëlimi i numrit të punëtorëve të gjetur të cilët kanë punuar pa kontrata pune, rritjes së kujdesit për plotësimin e kushteve për punë, sigurimin e ambientit më të përshtatshëm për punë, rritjes së numrit të subjekteve që kryejnë trajnimet adekuate për punëtorët për të kryer punë të sigurtë , sigurimin e pajisjeve personale mbrojtëse etj.

Këta tregues duhet të na japin motiv për të punuar edhe më shumë në të ardhëm për ti rrit përpjekjet tona në realizimin e misionit që kemi në realizimin e të drejtave të palëve në proces të punës, duke i respektuar ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë.

Konkluzionet

- Të rritet numri i inspektorëve të punës krahas nevojave reale për ti mbuluar me inspektim gjithë subjektet punuese,
- Të sigurohen zyre adekuate, pajisje për punë, komunikim dhe automjete për lëvizje në teren,
- Të funksionalizohet administrate përcjellëse për të kryer shërbime të shpejta, efikase dhe cilësore në kuptimin administrativ, teknik dhe financiar në shërbim të IP-së,
- Të organizohen trajnime adekuate për punëtorët e administratës
- Të shtohet numri i inspektimeve në sektorët si: ndërtimtari, energjetikë, tregti, industri metalike etj.
- Inspektimet të jenë më përmbajtësore , gjithë për fshirëse dhe palëve në marrëdhënie kontraktuese (punëdhënësve dhe punëtorëve) të iu jepen këshilla dhe detyrime si duhet të veprojnë për ti zbatuar saktë ligjet dhe aktet nënligjore nga marrëdhënia në punë, siguria dhe shëndeti në punë.
- Të rritet bashkëpunimi ndër institucional ndërmjet institucioneve relevante të ushtrimit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve,
- Të nxitet bashkëpunimi në mes të partnerëve social në gjetjen e mundësive për përmirësimin e kushteve të punës si dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që kanë njëra palë karshi tjetrës në marrëdhëniet kontraktuese.
- Të kryhen më shumë herë inspektime sidomos në vendet ku inspektorët konsiderojnë se është e nevojshme për të vepruar në parandalimin e aksidenteve të mundshme në vend të punës.
- Të urdhërohen punëdhënësit ti bëjnë kontrollimet shëndetësore nga mjekësia e punës për punëtorët sidomos të atyre punëtorëve që punojnë në lartësi dhe të punëtorëve që punojnë në kushte të pa favorshme me të punës (pluhur, temperaturë të shtuar, ndriçim jo adekuat, ambient ku ka gazra dhe avuj të dëmshëm, rrezatim, dridhje, zhurmë të shtuar etj) si dhe
- të obligohen punëdhënësit të bëjnë matjet dhe kontrollimin e këtyre faktorëve të dëmshëm në vend të punës për të siguruar ambient të përshtatshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm për punë.
- IP-ja të organizoi trajnime adekuate për inspektorët e punës që ti trajnoi ata në ushtrimin cilësor të funksionit të tyre nga lëmi i sigurisë dhe shëndetit në punë.

Grafikonet

Raporti zyrtar




Figura 1: Inspektimet ndër muaj




Figura 2: Inspektimet ndër muaj sipas sektorëve




Figura 3: Inspektimet sipas ankesës ndër muaj




Figura 4: Inspektimet sipas veprimtarisë




Figura 5: Inspektimet sipas llojit të inspektimit




Figura 6: Inspektimet sipas ankesës të ndarë në sektorë




Figura 7: Inspektimet sipas ankesës ndër muaj (për sektor)




Figura 8: Masat administrative




Figura 9: Rastet në shkallë të dytë




Figura 10: Punëtorët/et e inspektuar/a ndër muaj




Figura 11: Gjobat ndër muaj

Marrëdhënia e punës




Figura 12: Punëtorë/e dhe subjekte të legalizuara ndër muaj




Figura 13: Punëtorët e inspektuar me kontrata të punës ndër muaj




Figura 14: Punëtorët/et pa kontrata të punës ndër muaj sipas gjinisë




Figura 15: Shkeljet e evidentuara në kompenzime, paga jubilarë, dhe shujta




Figura 16: Punëtorët/et e inspektuar/a sipas veprimtarisë

Siguria dhe shëndeti në punë




Figura 17: Angazhimi i ekspertëve për Siguri dhe Shëndet në Punë




Figura 18: Obligimet e punëdhënësit




Figura 19: Aksidentet në vend të punës




Figura 20: Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve/eve

Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve




Figura 21: Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve

Krahasimi ndër vite (2016 – 2021)




Figura 22: Inspektime të rregullta ndër vite




Figura 23: Inspektime të përsëritura




Figura 24: Inspektime me kërkesë të palës




Figura 25: Inspektime të përbashkëta




Figura 26: Punëtorë/e të legalizuar/a




Figura 27: Vërejtje të shqiptuara




Figura 28: Gjohat të shqiptuara




Figura 29: Punëtorë/e të inspektuar pa kontrata




Figura 30: Punëtorë/e të inspektuar/a (sipas gjinisë)




Figura 31: Planifikimet emergjente

Obligimet e punëdhënësit




Figura 32: Obligimet e punëdhënësit

Aksidentet në punë




Figura 33: Aksidentet në punë

Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve




Figura 34: Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve




Figura 35: Kushtet teknike